

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

85H-1  
A 69

Zenel  
Anxhaku

# Valet

POEZI


*844-1*  
*A 69*

ZENEL ANXHAKU

# VALËT

poezi

11296.



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

---

**KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1977**

Si mundet gjoksi ta mbajë një zemër  
që rreh nën të me peshën e agimit,  
një zemër ku përmbledhur janë të gjitha këngët  
dhe krahët e palodhur të gëzimit.

Shpërthe!

Sa bukur kur sheh,  
synë e agimit të çelë.  
Sa bukur kur sheh  
jetën që rrjedh,  
jetën që ngrihet e zien  
si det.

Shpërthe!

## DUKE LEXUAR VELLIMIN XIX TË SHOKUT ENVER

Shumë dimra kaluan për të ardhur këtu,  
por ai ishte tmerrësisht i ftohtë;  
armiqjtë i kishim të egër e të shumtë,  
tradhtia hapej si hije në botë.

Nga ky dimër s'do dalin shqiptarët,  
do mbyten mes borës e erës.  
Por ne të bashkuar përballë dimrit të ashpër  
kishim në zemër shpërthimin e pranverës.

## ZJARRI YNÉ . . .

Në çdo mal u ndez një zjarr,  
nata u bë ditë;  
bie dielli delngadalë,  
varet përmbi Drin.

Zjarri që na ndezi zemrat  
ndezi malet dhe lumenjtë,  
nëpër diga shkruajnë emrat  
dhjetëra Promete.

Do lexojnë emrat nipat  
dhe do thonë me respekt  
«Shumë të fortë kanë qenë gjyshat,  
më të fortë se Prometeu. . .»

Zjarri ynë ngrohu shtëpitë,  
ngrohu ëndrrat më të mira;  
zjarri ynë ngroh taní,  
do të ngrohë dhe nip stërnipat. . .

## S A M I R È

Sa mirë kur dielli mbi qerpik  
dorën lehtë ta vë  
dhe derdh gëzimin pikë-pikë  
një zog që loz me të.

Sa mirë kur turresh nëpër udhë  
si një përrua i rrëmbyeshëm  
dhe njerëzit rreth janë të tutë,  
të mirë, të thjeshtë e të natyrshëm.

Sa mirë kur ngjitesh nëpër skela  
me diellin rrokesh qafë për qafë,  
ndërton e ngre këngë të reja  
me vrull e forcë të pamatë.

Sa mirë kur djersa si kristali  
pikon mbi ballin e skalitur  
dhe si ortek që zbret nga mali  
gëzimi vjen duke u rritur.

## L U M T U R I A

Si qenka kështu lumturia  
e thjeshtë, e natyrshme, e prekshme;  
plisat thërrmoj në duart e mia  
dhe ndiej dashurinë e fuqishme të njerëzve.

Shtrëngoj dorën e babait që lëroi arën,  
dorën e nënës që barin pastroi,  
dorën e vajzës që hodhi farën-  
me dhjetëra duar shtrëngoj.

Dhe them me vete: ja, lumturia  
hapet si një det i bardhë.  
Plisat thërrmoj në duart e mia  
dhe ndjej aromën jetëdhënëse të saj.

## MARSH STUDENTESK

Populli na solli këtu  
të ngjisim majat e shkencës,  
net të gjata pa gjumë,  
transhetë njëra pas tjetrës.

Fronti ynë është i vështirë, —  
në ballë më shokët punëtorë;  
kush ngel në vend t'i japim ndihmë,  
kush iktuehet prapa' është dezertor.

Fluturake janë ditët studenteske,  
mos thoni: «Ç'bëhet kështu?»  
Kalin e kohës ta kapim prej frerëve,  
s'e lëmë të vejë kuturu.

Me të të vemi në shtigje që s'u shkelën,  
të vemi në majë që kurrë s'u zunë, —  
nxënës të mirë në shkollën e jetës  
me libër, kazmë e pushkë.

## PRANVERA

A e ndien pranverën?

Në zemrën e dheut lëvizin

mijëra krijesa të gjalla

që krijojnë dhe rikrijojnë jetën.

A e sheh pranverën?

Mijëra gonxhe të shëndetshme

presin të shpërthejnë nesër.

A e dëgjon pranverën?

Nga malet rrëkezat gumëzhijnë, si bletët,

të dashuruara me detin, të dashuruara me erë,

Vështroje, dëgjoje pranverën...

## P E S H K A T A R

Shtrat i kaltér, mbulesë e kaltér  
të mbështjellin rrëth e qark  
dhe shumë larg  
i zgjasin krahët,  
peshkatar, o peshkatar!

Deti sot është i qetë,  
nuk ka erë, nuk ka dallgë,  
veç ka fresk,  
veç ka peshk  
jepu krahëve, peshkatar!

1972

## VALËT

Buzë detit çohen valët  
dhe thonë fjälë që i kanë thënë një mijë vjet  
dy mijë vjet më parë,  
Fjalë të lashta e të stërlashta  
fjalë të dëgjuara me miljona hërë...  
Por unë prapë dua t'i dëgjoj,  
të bisedoj me valët,  
të ndiej bukurinë e pashtershme të fjalës...

Deti i vjetër është i vjetër  
dhe këtë vjet është i vjetër  
dhe këtë vjet është i vjetër  
dhe këtë vjet është i vjetër

## PËR TOKËN TIME

Ç'ma bën të shtrenjtë këtë tokë të pakët,  
këtë tokë të vogël, të ngushtë si djep?!...  
Qeleshemënjanë zbresin shqiptarët  
siç zbresin nga malet e lartë përrenjtë.

E ia marrin bashkë një kënge trimash,  
shikimi u çan mjegulla e muzgje;  
heronj të lindur në dhetëra Jutbina,  
në Pojskë, Pezë a në Kodrën e Kuqe.

Cel trëndafili në zemrën e tyre,  
agimi i qetë rri mbi fustanellë;  
qielli mbushet an' e kënd me yje,  
dielli lulet si zemrat i cel.

## NJEREZIT E MI

Njerëzit e mi nuk ngritën piramida,  
s'ndërtuan kopshte me krahët tek era,  
veç lugët i gdhendën e i bënë bilbila,  
veshjen e kishin të bukur si pranvera.

Fëmijëve u thurnin këngë në djepe  
t'i merrte gjumi, të rriteshin shpejt;  
këngë kënduan në dasma dhe vdekje  
njerëzit e mi poetë.

Njerëzit e mi e deshën të bukurën,  
megjithëse të ashpër, qenë romantikë;  
i deshën lulet, këngën, fluturën  
dhe atë më të bukurën — lirinë.

## ME SHPATË NË DORË

Shaluar mbi një rapsodi  
më vjen pranë Gjergj Elez Alia.  
Nga nëntë burime pi  
dhe shkruaj poezi,  
nga nëntë dyer bujt te Liria.

Zogu i bjeshkës këngën ka nis',  
nën harpë ylberi ushton lahuta;  
nëntë vârre Gjergj Elez Alia kish,  
nëntë herë vdekjen e mundi si burrat.

Dhe shekujt kalon me gjokun e bardhë,  
me shpatë në dorë çan në histori;  
shkel bajlozët e egër me nam  
pa pyetur pér emrat dhe vendet nga vijnë.

Sy shqiponje, plagët e tij,  
vigjëlojnë në malet e mia;  
nga nëntë burime pi dhe shkruaj poezi,  
nga nëntë dyer bujt te Liria.

## PARA MONUMENTIT TË KOSTANDIN KRISTOFORIDHIT

Me një bllok në dorë shëtit nëpër pazar,  
ndalet dhe mban shënime;  
ulet këmbëkryq e flet me një fshatar,  
rrjedhin si burim fjalët e shqipes.

Njerëzit me çallma e shohin me dyshim:  
Ç'djall fut në bllokun e vogël?  
Flasin e shajnë turqisht,  
mallëkime nxjerrin prej gojës.

S'e dinin njerëzit me çallma e tespie  
se ai do të mbetej gjithmonë  
me bllok në dorë, mes fjalëve të shqipes,  
i derdhur përjetësisht në bronc.

Ranë minaretë që shponin qiellin,  
një monument për të u ngrit në Elbasan;  
ai ecën dhe bisedon me njerëzit,  
me një bllok në dorë shëtit në bulevard.

## KAÇANIK, SHKALLË E RËNDË . .

Kaçanik, shkallë e rëndë,  
gurë më gurë e këngë më këngë;  
preka në mantelin tënd —  
zjarr e flakë ish i tërë.  
Hajde, burra, hop në këngë,  
hekurin të hamë me dhëmbë,  
Kaçanik, shkallë e rëndë.

Hutë, moj hutë, e egra hutë,  
veç një shpirt e veç një plumb —  
bash në mish do ta ngul,  
bash lirinë do ta puth  
nëpër shkëmb e nëpër gurë,  
nëpër zjarr e në lahutë,  
hutë, moj hutë, e egra hutë.

O Idriz, Idriz Seferi,  
zemër shqipe, këmbë dreri,

11296

jeni ju apo nuk jeni  
të padukshëm si eteri,  
të pakapshëm si sqifteri,  
të pamposhtur si Skënderi,  
O Idriz, Idriz Seferi...

Shefqet pasha kryelopa,  
ç'bën ashtu me ato topa?  
Janë fëmijë e nuk janë gogla,  
janë shtëpi e s'janë lodra. —  
Le ta dijë e gjithë bota,  
s'mposhten kurrë malet tonë,  
me ca gjyle e ca topa,  
Shefqet pasha kryelopa...

Ani, burra! Vdes i lumtur!  
Kush lufton i patundur,  
zemërzungjarr e fytyrbuçkur,  
zemërzungjarr e krahëflutur —  
emri kurrë s'ka për t'i humbur.  
Ani, burra! Vdes i lumtur!

Kaçanik, shkallë e rëndë,  
gurë më gurë e këngë më këngë  
preka heroizmin tënd...

## MOTIV ARBERESH

Të fala katundit të bardhë,  
loti i ndarjes s'më le të shoh;  
këpus lule e lulet më thahen,  
mallin ato s'ma nxjerrin dot.

Po nisen drejt detit anijet,  
uratën erdha të marr;  
lulet që mora do vyshken,  
zemra me mall do qajë.

Më jep uratën eëmbël,  
lulet që vyshken t'i gel,  
se malli do më bjerë në zemër  
si gur i rëndë në det.

Unë lulet të çelura i duar  
t'i kem në dheun e huaj,  
lulet t'i prek, t'i shoh  
kur zemra të heqë, të vuaj'.

## Ç'THANË TRËNDAFILAT

*Në kujtim të 4 Shkurtit.*

Ç'thanë trëndafilat që çelën në shkurt?  
Thanë se jemi të kuq nga gjaku  
e do të jemi gjithmonë të kuq  
nga gjaku që u derdh në shkurt...

... Xha Rizai ishte bahçevan.  
I trokitën në portë me natë  
— Tak, tak!  
Dera u hap.  
Ca gjermanë e morën xha Rizanë  
dhe në mes të bahçes e vranë.

— Dhe trëndafilat i paske bërë të kuq,  
dhe lule s'na solle për leitnantin tonë.  
Na, pra!  
thirrën dhe e vranë...

... Nënë Hibja mbeti pa sy  
me një këmbë këtej e tjetrën në varr,  
por nënë Hibja djem kishte dy  
dhe të dy i kishte çuar në mal.

Ah, qentë e Xhafer Devës  
erdhën dhe e gjetën;  
nga dy karikatorë  
mbi trup e kokë i shkrehën...

Dajë Bimi ishte këpuçar,  
gjithë jetën kishte ndrequr këpuçë;  
duart nga çekiçi i ishin bërë plagë  
por këpuçë s'kishte veshur kurrë.

Tek ai erdhi një skuadër e tërë  
dhe një oficer i gjatë si hije e vdekur,  
me një palë syze të florinjta mbi hundën e gjerë  
me një lloj... biçim të qeshur.

— Ah gut!  
Ti ndreq këpuçë, mor këlysh i kuq,  
dhe i çon në mal te partizanët.  
Tani do të bëjmë një tabut  
ku të futen gjithë këpuçarët.

Dajë Bimi qeshi, qeshi në heshtje  
siç qeshte me fëmijët e zbathur në rrugë

kur mendonte i gëzuar me vete  
se nesër do të kishin të gjithë këpucë...

Qeshi... — Ah po qesh! Aha!

Copëtojeni, pra!

Tri bajoneta po futeshin në trup

dhe ra dajë Bimi që ndreqte këpucë

dhe këpucë nuk kishte veshur kurrë...

... Këto thanë trëndafilat që çelën në shkurt,  
trëndafilat që do të mbisin gjithmonë të kuq.

## LETS - 10 SHOKËT

*Lejla Malos, dëshmore*

E torturuan Lejlanë e vogël  
që të tregonte shokët.  
E morën,  
nën një pemë e morën,  
dhe e rrahën, e goditën derisa u lodhën.  
Dhe prapë ulërinë: Ku janë partizanët? Ku?  
Lejlaja tregonte zemrën e saj të vogël...

## BALADA E DJALIT TË VETËM

E kish nëna djal' të vetëm,  
nëna s'kishte tjetër;  
erdhën në një natë të egër  
e morën djalin e vetëm.

E çuan zvarë nën lajthitë,  
ia shkulën flokët, ia nxorën sytë,  
ia thyen dhëmbët e bukur të tij,  
e vranë së fundi te lajthitë.

Kërkoi nëna lëm më lëm,  
kërkoi nëna këngë më këngë  
dhe djalin e gjeti lëm më lëm,  
djalin e gjeti këngë më këngë.

## Ā P S O D Ě T

Shëtisin në balada heronjtë,  
baladat sa toka të lashta,  
trokasìn në vargje patkonjtë,  
shpatat në rima të varura.

Ku vanë, ku vanë rapsodët e panjohur  
që jetën e shkrinë për të përjetësuar  
heronjtë?

Dolën nga populli e u tretën në popull,  
Homerë të panjohur mbetën gjithmonë.

Dhe na lanë këto këngë të bukura,  
këta heronj që ecin në balada;  
gjëmon nëpër male lahuta,  
shpatat në rima të varura.

## SHOQJA E FËMINISË

Parmenda e ngriti në këmbë këngën time,  
Bardhylja, lopa e shtëpisë, qumësht i dha të pijë,  
vargjet ndezur prej kandilëve  
një ditë u veshën me dritë.

Kënga ime, shoqe e fëmijnisë,  
sa herë u lëkund dhe ra  
dhe prap' u ngrit, nga pragu i avllisë  
nisi udhë në shtigjet e mëdha.

— Udhë të mbarë! — fshatarët i thanë,  
Bardhylja derdhi qumështin pikë-pikë,  
pemët shkundën mollë e dardhë,  
kënga ime — shoqe e fëmijnisë.. .

## G J Y S H I

Flet për tokën gjyshi im  
këndon për të plot me përgjërim...

Dhe shpesh kur ndodhet i vetmuar pranë saj  
bisedon me të sikur të ish njeri  
ashtu shtruar, shtruar dhe pastaj  
punën fillon përsëri.

Në festat e dasmat  
dollinë e tokës e ngre ndër të parat,  
paguren e rakisë e shkund me gëzim,  
në sofër godet me grusht  
dhe dollinë e pi me fund.

Shpesh kur bisedojmë bashkë  
e më pyet si vete në shkollë,  
bisedën e mbyll duke thënë ngadalë  
se qejfi ia ka të bëhem agronom.

Dhe kur i lexoj vjersha për tokën  
nga duart ma merr fletorkën  
dhe lart e tund me gëzim.

## NË VJESHTË

Dal sot rrugëve vjeshtore  
me laps e kartë në xhep,  
dua t'i fal vjeshtës bukuroshe  
ca vargje lidhur në buqetë.

Takoj fshatarkat në arat e gjera,  
vjeshtën harroj e ulem me to;  
flas e grindem për të mbjellat  
dersa yjet skuqin si mollë.

Këpus një lule e marr një varg,  
udha më shpie në stane te barinjtë;  
përkulen nën zilet, nën qumështin e bardhë  
shqerrat më vështrojnë në sy.

Shqerrat afrohen e më lëpijnë dorën,  
sikur ta dijnë se jam prej dere barinjsh;  
era e malit më kap nga flokët,  
më jep një lule që s'e ka njeri.

## ME SHARRËXHINJTË

Nuk erdha këtu thjesht si romantik  
të shoh pishat e gjata bleroshe,  
erdha këtu te sharrëxhinjtë  
të mësoj nga klasa punëtore.

Të mësosh nga klasa punëtore  
s'do të thotë vetëm të rrish me ta,  
do të thotë të futësh këmbët nën dhjetë jorganë  
dëbore,  
të mbash në krahë sharra të mëdha.

Djersa sumbull të ndrisë në fytyrë  
megjithëse temperatura është nën zero gradë;  
tejkalimin ta quash detyrë  
dhe të punosh me cilësi të lartë.

## KJO RRUGË QË NGJITET MAJËS SË MALIT

Ç'më kujton kjo rrugë që ngjitet majës së malit  
e zbret pastaj turravrap?...:

Nëntor 1966.  
Vrapojmë për Dibër.  
Shok, a mund ta ndezim pak?  
Oh, sa ftohtë!  
Dhe bora bie radhë-radhë,  
dhe tërmeti ka qenë i fortë,  
tepër i fortë. .

Nxitojmë për Dibër:  
vullnetarët e Shkodrës,  
vullnetarët e Krujës,  
vullnetarët e Vlorës,  
vullnetarë, vullnetarë... .

Autokolona ndal...  
Ç'ka ngjarë?  
Mos u zu rruga prapë vallë?  
Bora është e madhe  
dhe e fortë kallkan.

Ç'të ketë ngjarë?  
Në krye të autokolonës një plakë.  
Është ulur dhe qan  
një nënë dibrane  
60-70 vjeçare.

Qan, janë lotë gjëzimi  
lotët i bien çurk në faqe  
dhe s'di të pushojë nëna dibrane  
kur sheh vargun e pafund të vullnetarëve.

— Rrofsh sa malet Enver,  
marrsh nga ditët tonë!  
Plakën e pasojnë me qindra të tjerë,  
buçet autokolona!..

Ja ç'më kujton kjo rrugë që ngjitet majës së  
malit  
e zbutet pastaj turrvrap...  
.

## KËNGË PËR MOSHATARIN TIM

*Kushtuar të riut Shkëlqim Deraj,  
që ra në ndërtimin e hidrocentralit.*

...Ndoshta vargjet e mi  
janë të para për ty,  
siç janë lulet e para pranë lapidarit.  
I gjithë heroizmi dua të jetë aty  
dhe dashuria prej moshatari.

Të bukura qenë pranverat e tua  
dhe të gjitha atdheut ia dhe.  
E një mëngjes apo u zgjuam  
për ty lexuam në gazetë.

Për ty dëgjuam në radhë  
dhe në urbanin mbushur me punëtorë  
e na u duk se ndjemë sinjalin: Alarm!  
Në revolucion  
për t'u ngritur më me forcë.

Dhe ne moshatarët që zgjasim shima,  
dhe ne moshatarët që ngremë diga,  
që çojmë pallate e lëvizim makina,  
që çajmë tunele e hapim drita  
morëm forcë dhe guxim të ri.

E bukur, shokë, kjo udha jonë!  
E kush e ndal dot rininë?  
E pastër si gurrat e maleve  
e bukur si vetë pranvera,  
  
e fuqishme si  
rrahjet e dallgëve,  
e re dhe i çiltër ngahera.  
Kështu janë moshatarët e mi.

Vështroni uzinat që i buzëqeshin diellit  
dhe valles bukur ia nisin,  
ne vetë të ardhmen pëershëndesim  
dhe bëjmë të afrohet komunizmi.

2.

Shoku ynë moshatar!  
Trupi yt në duart e xha Gilos  
del pareshtur nëpër sytë tanë  
dhe lebrit që mblidhen e ia marrin isos  
(me këngë përcillen trimat e vrarë).

Kështu i mori në dorë xha Gilua  
shokët e vrarë dikur në luftë,  
mes zjarrit e plumbave çohej isua  
e shokët çanin më me vrull.

Dhe ja tani si rrëth një vatre  
ne mblidhem i rrëth teje  
dhe ngrohim zemrat,  
dhe ngrohim èndrrat.

Buzëqeshja jote, si shkëlqim pranvere,  
është bërë më e zjarrtë nga kënga.

Pranë teje të gjithë ne moshatarët  
bëjmë një betim sublim:  
në rreshta gjithmonë do jemi të parët,  
gjithmonë të gatshëm për marshim!

...Ndoshta vargjet e mi  
janë të parat për ty,  
siç janë lulet e para pranë lapidarit.  
Do desha që gjithë heroizmi të jetë aty  
dhe gjithë dashuria prej moshatari.

1973

## FSHATARËT PËR NË AKSION

Vargu i makinave rend  
me trokun e zgjatur gazmor,  
fshatarët qeshin, kërcejnë  
sipër së bashku mbi spond.

Për ku kështu udhëtarë,  
mos janë ndoshta dasmorë,  
gërneta me iso nga pas  
në ç'derë të lumtur ju çon?

Përzihen borijet te kthesat,  
mpleksen me këngët, me vallet,  
si nxënësit që marrin dëftesat  
gëzojnë sot vajzat fshatare.

Udha përpara zgjatet  
plot dritë, gaz e diell;  
gëzojnë sot vajzat fshatare,  
këngën e ngrejnë në qiel.

## PRANVERË NË VJESHTË

Kokulur lisat si rapsodë  
diellin vjeshtak mbi supe mbajnë;  
vjeshta mbushur rrush e mollë  
përkul mbi to ballin zeshkan.

Me shëndet, moj vjeshtë, moj miqe flokëkuqe,  
me shëndet prodhimin e mbarë;  
ti mund të fishkësh gjethje dhe lule  
por jo djersën tonë mbi ballë.

Pa shih, pa shih, kjo djersa jonë  
gëzimin sì lule po çel;  
fushat e arat u mbushën plot,  
pa shih, moj vjeshtë, shih ç'pranverë!

## G J Y S H E S

Mos ki frikë pér mua, moj gjyshe,  
se perëndive u kam shpallur luftë  
dhe i urrej fjalët e tyre  
aq shumë sa s'kam urryer kurrë.

... Ty shpesh gjumi të del  
dhe zgjat nga unë krahët e tua,  
vështron mos xhindet vijnë përreth,  
e gatshme pér t'më mbrojtur mua.

Por në dhomë ndihet veç sahati i murit,  
në qielj veç hëna kokën nxjerr;  
më kot t'i bie të flesh e fundit  
më kot e para gjumi të del.

## MËNGJES NË FSHAT

Këndoijnë këndezat në degët e ftonjve,  
agimi zbardh fletë më fletë;  
turfullon në hajat lopa qumështore,  
përtyp me oreks barin e blertë.

U zhduk nga qielli hëna si drapër  
dhe yjet kallnj të artë;  
ç'ëndërr të bukur panë sonte fshatarët —  
yjet korrnim arë më arë...

... Yje bien nëpër fushat tonë  
si shi i ngrohtë dhe i ëmbël vere;  
toka e fryrë nga vlaga dhe aroma  
pret dorën e kujdeshme të njerëzve.

## GÈZIM DASME

Kënga, vallja jehuan  
deri natën vonë,  
mollët bënë më shumë lule,  
lulet bënë mollë...

## KËNGË E HERSHME

...  
O ju zogj shtegtarë,  
dua t'ju them një fjalë;  
A s'më patë një vashë  
buzë detit për matanë,  
qan ditë e qan natë?..

Le të bëhet erë,  
le të bëhet shi,  
le të bëhet diell  
dhe këtu të vijë.

Thojini ju, zogj,  
se unë s'kthehem dot;  
në një tjetër tokë  
dergjem përgjithnjë.

Tregojini ju, zogj,  
jetën e rëndë;

orë pa orë  
futur në llagëm.

Qymyrin e zi  
e hëngra me dhëmbë;  
pa gaz, pa dritë,  
pa sy, pa këngë.

Tregojini ju, zogj,  
mallin që më hoqi, —  
gjoksin ma shpoi,  
jelekun ma dogji...

## DANTE ALIGERI

Nga supet gënjeshtat i flake  
dhe mbajte të vërtetën me vete;  
në ferr hodhe sojin e papëve,  
peshkopët mbuluar me vese.

Çdo gjë që pe në dritë të diellit  
si plak e shoshite mirë;  
gjithçka të ligë ia përçolle ferrit,  
gjithçka të mirë e mbajte për njerinë.

Vitet vijnë e ikin me dumane,  
shekuj ngrihen, bëhen përmendore, —  
mbeti mes nesh komedia e madhe,  
gjithmonë e dashur, e bukur dhe njerëzore.

Ata luftuan dështet  
ata luftuan dështet  
ata luftuan dështet  
ata luftuan dështet

## KOMUNARËT E FUNDIT

Ata luftuan dhe për ne,  
ata luftuan dhe për mua  
kur në varrezat Pjer-Lazhez  
luftonin me armë në duar.

Duart e ashpra, vrarë nga puna,  
flokët përzhitur nga baroti;  
epitafet nga varret e gurta  
binin si pika të rënda loti.

Kërcisnin pushkët e gjata,  
pëllëmbë e gjak — barot;  
afroheshin në heshtje versajasit,  
robër kérkonin më kot.

— Rroftë komuna! — thërrisnin  
me zë të plotë si deti  
punëtori përkrah ministrit,  
heronjtë që sulmonin qiellin.

Ata luftuan dhe pér ne,  
ata luftuan dhe pér mua  
kur në varrezat Pjer — Lashev  
vdisnin me armë në duar.

TÈ FALA!...

Moj erë e lirisë, erë krahlehtë  
që rri në çdo breg  
e shkon në çdo majë  
të fala m'i ço arabit lëkurzez  
me sytë e thellë, të pastër si oaz.

Dhe ço në Vietnam dashurinë shqiptare,  
urimin e thjeshtë të malësorit fisnik;  
puthi vogëlushët e bukur sybajame,  
plagët dashuria çuditërisht t'i mbyll.

Pranë Indit dhe Gangut,

Tamizit, Missisipit  
ti, erë krahëlehtë e lirisë, qëndro.

Të fala, të fala shokëve u ço!

### SHOKËVAT

Shokëvati është një përgjigje e vërtetë  
e rritur me veshje, që  
në mënyrën e saj  
dëshiron që të bëjë  
një shokëvët e vërtetë.

Shokëvati është një përgjigje e vërtetë  
e rritur me veshje, që  
në mënyrën e saj  
dëshiron që të bëjë  
një shokëvët e vërtetë.

Shokëvati është një përgjigje e vërtetë  
e rritur me veshje, që  
në mënyrën e saj  
dëshiron që të bëjë  
një shokëvët e vërtetë.

## NE FURTUNAT KLASORE

Në furtunat klasore nga poli në pol  
rriten njerëz që më ngjasin shumë,  
vëllezër, motra, shokë  
me fytyrë e mendime si unë.

Mund të jenë nga vende të ndryshme,  
të bardhë e të zez,  
mund të quhen Xhoze, Sju dhe Zhak,  
mund të jenë fëmijë, të rinj apo pleq,  
punëtorë, fshatarë apo shkrimtarë.

Një det i tërë me valë binjake  
vëllezër, motra, shokë,  
rritet armata proletare  
në furtunat klasore nga poli në pol!

Dhe duhet të dalë një Homer, i ri  
të këndoje forcën dhe lavdinë e saj;  
këndo ti, bard i bardhë a i zi,  
Xhoze, Sju apo Zhak...

## BALADË PËR STUDENTIN SPANJOLL

Alvaros studjonte letërsi,  
Alvaros me trupin e vogël;  
Shekspirin e Gëten i donte ai,  
po mbi të gjitha deshte Lorkën.

— Alvaros, Alvaros! — i thirrën shokët  
kur plumbi e mori aty në demostratë;  
nga plagët çeli poezia e Lorkës,  
Lorka vetë u ngjall.

Mbi të u përkul hëna e Spanjës,  
si një lule iu ul mbi plagë;  
iu këput Spanjës dhe një tel i kitarës,  
kuçtimi i Republikës e dogji në ballë.

Alvaros studjonte letërsi,  
Alvaros me trupin e pakët;  
Shekspirin e Gëten i donte ai,  
por mbi të gjitha donte Spanjën.

## PARIZIANE

Paris. Dyqanka, kafene, kabare, magazina,  
udhë sa të duash,

Por për çdo gjë paratë në dorë, zotni!

T'u shkrep të ngjitesh në Kullën Ejfel,  
mrekulli!

Po për çdo kat ngjitet edhe kamata,  
zotni!

T'u shkrep të shkosh në muzeun francez,  
prapë mrekulli!

Por prapë paratë në dorë, zotni!

T'u shkrep të shkosh në opera  
të dëgjosh një pjesë me art,

urdhëro, kolktuqet e ngrohta,  
por veç mos harro paratë!

Shitet i lumtur në Shanz — Elize  
dhe veten e ndien të lumtur,

kur ja, stomaku pér dreq  
fillon nga puna e tij.  
Dhe ikjo s'ëشتë se t'u shkrep  
ty ashtu më kot, —  
stomaku, pér dreq,  
ka një vullnet të fortë.

Bukë! Paratë në dorë, zotni!

S'ke! Atëhere rri, atëhere fli.  
Atëhere vdis më mirë, zotni!

Atëhere rri, atëhere fli.  
Atëhere vdis më mirë, zotni!  
Atëhere rri, atëhere fli.  
Atëhere vdis më mirë, zotni!

Atëhere rri, atëhere fli.  
Atëhere vdis më mirë, zotni!  
Atëhere rri, atëhere fli.  
Atëhere vdis më mirë, zotni!

## NJË POETI DEKADENT

Ti e quan njeriun qenie të mjerë  
që vërtitet nga era si një kokërr rërë;  
takohet, urrehet me të tjerë,  
ulërin si kopea e qenërve.

Të tillë qenie vërtet ka,  
por vetëm aty në stani tuaj,  
hipi qafëleshë që shkrihen me kitare,  
me kryq në qafë e droga në duar.

Ti thua se njeriu është në perëndim  
dhe jeton fundin e tij,  
por të gjithë e dinë, dhe fëmijët e dinë,  
kush është ai që çdo ditë jep shpirt.

Heshtni ju laro, muza të vdekura,  
qenie të mjera, zë shkretëtire —  
rrofshin vjershat, rrofshin poemat  
që venë në qendër të tyre njerinë,

## A M E R I K A

Ti puth me afsh qenin, zonjushe,  
dhe i ve një kravatë në qafë;  
dhe s'mund të thotë ndonjë fjalë askush  
për qumështin që pi qeni me fat.

Sado pak të kollitet bubi  
ti rend me vrap për në spital;  
të dridhen duart, të dridhet supi,  
nxjerr nga xhepi mijëra dollarë.

Doktor profesori me syze të trasha  
mendon në heshtje diagozën  
dhe shënon në receta dhjetra barëra,  
ngre telefonin, alarmon pavijonet.

Ti hesht e pret në ankth, zonjushë,  
të prek fort një ngjarje e tillë,

por mijëra njerëz enden udhëve  
pa punë, pa bukë, të zyrtë e më vetmi.

Plot llum, rrëmujë Amerika...  
rendin, heshtin avenjutë,  
reklama, policë e drita,  
hije, vetmi e zhurmë...

## ULENI ZËRIN, ZOTËRINJ!

Në sallat e OKB-së në Nju-Jork  
gérthasim zotérinjtë pér paqe;  
qeshin e flasin më kot  
nxehen në çast e ndukin mustaqet.

Uleni zërin, zotërinj!  
Në lagjet pérreth fle një fëmi  
dhe gjumi i tij  
është më i shtrenjtë se gjithë fjalët tuaja, zotërinj...

# ZGJOHU, DRUVAR!

*Revolucionarëve kilianë*

Zgjohu, druvar,  
dhe juntën fashiste hidhe në varr!

Gjaku me gjak!

Terrori i bardhë  
shtriu në rrugë  
mijëra të vrarë –  
shokët e tu  
dhe shokët tanë.  
Zgjohu, druvar!

Tanket e egër zinxhirçelik  
shtypën punëtorë të thjeshtë;  
në çdo qendër e udhëkryq  
megafonët tunden në erë.

Një fëmi në një tog me plehra  
kërkon diçka për të ngrënë;  
më tutje grataçielat  
me pamje të rëndë.

Ah, Kili me tokë të pasur  
plot ar e krom e bakër,  
në plehra duart ka zgjatur  
ky fëmi i varfër.

Zgjohu, druvar!  
Në katedra u ngjit Hitleri  
dhe flet për jetën e vet;  
zgjuhu, druvar, dhe bjeri,  
zhduke atë bar të keq.

Duart e CIA-s zgjaten —  
preji ato duar, druvar!  
Me komplate ushtarake  
jeton Shtëpia e Bardhë.

Zgjuhu!  
Çohu!  
Çasti erdhi,  
dërë më derë troket.  
— Ngrije sëpatën dhe bjeri! —  
Neruda nga varri thërret...

Zëri i tij të thërret në luftë,  
vare në sup kitarën;  
të jehojë kënga si pushkë...  
— U zgjuan të gjithë druvarët.

Në pesë kontinentet  
sëpatat e tyre bien mbi botën e vjetër...  
Shëmben nga rrënjet trungjet e lashtë  
dhe mbin mbi ta  
një zambak i madh,  
një zambak i bardhë, druvar!

## KËNGËTARI I ZI

Mes tam-tameve dhe dhimbjeve  
lindi dhe u rrit kënga jote  
me një shpresë të bukur...  
E ndiej tek endet  
në plantacionet e pafundme të kafesë e të sheqerit  
e përcëlluar nga dielli i zjarrtë i tropikut,  
e larë nga të katër anët nga djersa dhe gjaku.

Kënga jote si një oaz i madh  
ku negrit lagin buzët e thara,  
çlodhen dhe rrugën vazhdojnë.

Këndo, ti bard i zi! Këndo!  
Me dorën drejtuar nga dielli...

## A F R I K A

Ushto, gjëmo, jeho!

Afrikë e zezë me ëndërr të bardhë,  
Afrikë e zezë me zemër të kuqe,  
Afrikë e zezë me qiell të kaltër,  
Afrikë e zezë me shpresë të gjelbër.

Afrikë – ylber i dridhshëm lirie.

## NË UJËRAT E MESDHEUT...

Nëpër ujërat e Mesdheut Flota e Gjashtë  
dhe luftanijet e Moskës dalin natën.

Vrapojnë nëpër ujëra këta piratë  
«Në emër të lirisë dhe paqës»...

Dhjetfish më të egër se kusarët e mesjetës  
ngërdheshen; komplotojnë e bëjnë plane;  
Mesdheu i kaltër tkurret prej peshës,  
lëkunden në brigje portokallet.

— Tmerr?! — Aspak. Nga vendi Teutës unë jam,  
i lindur dhe rritur me det;  
detin e njoh si stërgjyshërit e lashtë  
adrianë, liburnë e enkelej...

Unë vigjëloj me armë në dorë  
dhe u bëj zë dhe popujve fqinj:  
— Kujdes këta peshkaqenë shekullorë,  
kujdes këta piratë të rinj...

## PASQYRA E LËNDËS

Si mundet gjoksi ta mbajë një zemër .....	3
Duke lexuar vëllimin XIX të shokut Enver .....	4
Zjarri ynë .....	5
Sa mirë .....	6
Lumturia .....	7
Marsh studentesk .....	8
Pranvera .....	9
Peshkatar .....	10
Valët .....	11
Për tokën time .....	12
Njerëzit e mi .....	13
Me shpatë në dorë .....	14
Para monumentit të Kostandin Kristoforidhit .....	15
Kaçanik, shkallë e rëndë .....	17
Motiv arbëresh .....	19
Ç'thanë trëndafilat .....	20
Shokët .....	23
Balada e djalit të vetëm .....	24
Rapsodët .....	25
Shoqja e fëminisë .....	26
Gjyshi .....	27
Në vjeshtë .....	28
Me sharrëxhinjtë .....	29
Kjo rrugë që ngjitet majës së malit .....	30

Këngë për moshatarin tim .....	32
Fshatarët për në aksion .....	35
Pranverë në vjershtë .....	36
Gjyshes .....	37
Mëngjes në fshat .....	38
Gëzim dasme .....	39
Këngë e hershme .....	40
Dante Aligeri .....	42
Komunarët e fundit .....	43
Të falal... .....	45
Në furtunat klasore .....	47
Baladë për studentin spanjoll .....	49
Pariziane .....	50
Një poeti dekadent .....	52
Amerika .....	53
Uleni zërin, zotërinj .....	55
Zgjohu, druvar .....	56
Këngëtarë i zi .....	59
Afrika .....	60
Në ujërat e Mesdheut .....	61